



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 30.04.2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**I T E. GRUP**” sh.p.k, me NUIS K11323001H dhe adresë: Rruga Dytësore Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës: REF-90631-03-20-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Materiale për ndriçim”, me afat lëvrimi 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës dhe me fond limit 44.104.900 (dyzet e katër milion e njëqind e katër mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.45, datë 29.03.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**ELECTRICAL POWER ENGINEERING**” shpk me NUIS K81511012V me oferte ekonomike **41.250.000** (dyzetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “**I T E. GRUP**” shpk me NUIS K11323001H me ofertë ekonomike **34.526.000** (tridhjetë e katër milion e pesëqind e njëzetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**MAG UTILIES**” shpk me NUIS L52430023N me ofertë ekonomike **41.460.300** (dyzetë e një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori Ekonomik **“ELECTRICAL POWER ENGINEERING”** sh.p.k, me NUIS K81511012V.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “Electrical Power Engineering” sh.p.k nuk kualifikohet pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, përveç Formularit të Ofertës dhe pasqyrave financiare të vitit 2018-2019.

2. Operatori Ekonomik **“MAG UTILITIES”** shpk me NUIS L52430023N.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *”Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”*.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “MAG UTILITIES” sh.p.k dhe rezulton se ky operator ka paraqitur Deklaratë Konformiteti të lëshuar nga kompania “Schröder” për kontrollerin (pajisjen smart) por nuk ka paraqitur autorizim nga kompania “Schröder” ose nga ndonjë distributor i autorizuar nga kjo kompani për këtë produkt.

- Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *”Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose/dhe skeda teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, të shoqëruara me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, ku të jepen të gjitha karakteristikat teknike të tyre, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike. Paraqitja e shtojcës 10 “Specifikime teknike” si skedë teknike nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, e firmosur dhe vulosur prej tyre do të vlerësohet e pavlefshme.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

- Operatori nuk ka paraqitur katalog ose skedë teknike për kontrollerin (pajisjen smart) të produktit “Ndriçues rrugor LED 10.000 Lumen (Smart)” dhe “Ndriçues rrugor LED 8.000 Lumen (Smart)”.
- Skeda e dorëzuar për ndriçuesin ICONA-S-80W-4070-A1-9023 set to 65W-SMART “LED street light 10000 lm (Smart)”, prodhuar nga kompania NITEKO e paraqitur nga operatori ekonomik ka mospërputhje me skedën në katalogun e publikuar në website-n zyrtar të kësaj kompanie, përkatësisht www.niteko.com. Në katalogun e publikuar në web, pasqyrohet qartë se efijçensa e ndriçuesve të modelit ICONA S varion nga 100 lm/W deri në 145 lm/W. Pra, kompania NITEKO ndriçuesit ICONA S mund ti prodhojë me efijçencë maksimale deri në 145 lm/W. Në skedën teknike të paraqitur nga operatori rezulton se ndriçuesi ICONA-S-80W-4070-A1-9023 set to 65W-SMART “LED street light 10000 lm (Smart)” e ka efijçensën më të madhe se 156 lm/W, vlerë e cila nuk përputhet me vlerën maksimale prej 145 lm/W të cituar më lart.
- Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *”Operatori ekonomik duhet të dorëzojë për shtyllat (zëri 15-20 tek tabela e*

shtojcës 12) dhe për ndriçuesit (zëri 1-13 tek tabela e shtojcës 12), Çertifikatat e Konformitetit (CE). Për shtyllat (zëri 15-20 tek tabela e shtojcës 12) operatori ekonomik duhet të dorëzojë dhe çertifikatën për galvanizimin sipas normave të përcaktuara në shtojcën 10 “Specifikimet teknike”.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se mungojnë Çertifikatat e Konformitetit për produktet e mëposhtme:

Ndriçues dekorativ Konik LED 4.600 Lumen

Ndriçues rrugor 70W (Kompletuar)

Ndriçues dekorativ 150W (Kompletuar)

Ndriçues dekorativ me mbulesë rrethore LED 5.700 lumen

Spot tokësor LED 3.200 Lumen

- Nuk përmbush pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: ”Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e materialeve të pasqyruara në tabelën e mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.**

Nr.	Përshkrim Ndriçuesi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues rrugor LED 6.300 Lumen	copë	1
2	Ndriçues rrugor LED 7.500 Lumen	copë	1
3	Ndriçues rrugor LED 9.000 Lumen	copë	1
4	Ndriçues rrugor LED 10.000 Lumen (Smart)	copë	1
5	Ndriçues rrugor LED 14.000 Lumen	copë	1
6	Ndriçues rrugor LED 8.000 Lumen (Smart)	copë	1
7	Ndriçues dekorativ Konik LED 4.600 Lumen	copë	1
8	Ndriçues rrugor 70W (Kompletuar)	copë	1
9	Ndriçues dekorativ 150W (Kompletuar)	copë	1
10	Ndriçues dekorativ me mbulesë rrethore LED 5.700 lumen	copë	1
11	Spot tokësor LED 3.200 Lumen	copë	1
12	Prozhektor LED 8.800 Lumen	copë	1
13	Ndriçues shtyllë 3 Degësh	copë	1

Nga verifikimi i mostrave rezulton se mostra e paraqitur për “Spot tokësor LED 3.200 Lumen” nuk përputhet me specifikimet teknike të shtojcës 10 të DST-së dhe as me vetë skedën teknike të paraqitur nga operatori për këtë ndriçues, pasi spoti nuk është i orientueshëm siç kërkohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve ekonomik “I T E. GRUP” sh.p.k, me NUIS K11323001H dhe adresë: Rruga Dytësore Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **34.526.000** (tridhjetë e katër milion e pesëqind e njëzetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga “5 Maji”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes/ publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.04.2021

Ankesa: Nuk ka